



01/Nr. 9363/2020  
Data: 22.12.2020

## PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e nëntë -IX- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 26.11.2020 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtorë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Medina Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadstër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Amir Bushi (Udhëheqës i Qendrës për Punë Sociale), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Kryesuesi i kuvendit pasi konstataoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstataoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Kuvendit të Komunës.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Plotësimi i Komitetit për Komunitete si komitet obligativ në komunën e Hanit të Elezit.
4. Miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për përgjedhjen e drejtor/esh në Institucionin Parashkollar, Hani i Elezit.
5. Shqyrtimi i draft rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
6. Shqyrtimi i draft rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.
7. Shqyrtimi i informatës mbi gjendjen në shëndetësi.
8. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
9. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- përveç pikave të rendit të punës të cilat janë dërguar, kemi edhe një pikë shtesë të cilën e ka propozuar drejtoria për buxhet dhe financa, propozim vendim për transfer të mjeteve në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa për vitin 2020.

**Shabi Rexhallari** thekson:- me ligj e kemi të lejuar që të bëhen këto rregullime aty ku është e nevojshme në kuadër të kategorisë paga dhe mëditje në kuadër të drejtorive. Në bazë të buxhetit aktual të cilin e kemi në disa drejtori parashihet që ka mjete tepër dhe në disa janë mjetet të cilat janë të nevojshme që duhenë të plotësohen. Shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 38,119.00 € janë mjete tepricë që duhet të shpenzohen për obligimin dhe pagesën e shujtave, udhëtimin dhe mësimin e kombinuar për personelin arsimorë për vitin 2017, obligime që dalin nga kontrata kolektive. Ne e dimë që ndoshta ka obligime më tepër edhe për vite të tjera por për momentin komuna e Hanit të Elezit vetëm këto mjete financiare i ka, ndërsa drejtoria e arsimit ka parashtruar kërkesë në Ministri të Arsimit që me i kryer edhe obligimet e tjera por ende përgjigje nuk kemi marr. Vendimi nëse merret në këtë seancë do të jetë pikëpyetje se a do të ekzekutohet nga Ministria e Financave .

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është dashur që një ditë përpara me na u dërguar materiali në mënyrë që të jemi më të përgatitur me kohë në mënyrë që edhe për shujtat do të na ishte sqaruar më mirë për shkak se nuk jam i njoftuar se në çfarë mënyre do të paguhen. U potencua që në disa drejtori ka më shumë mjete dhe në disa drejtori ka më pak mjete a është planifikim i keq apo si ka ndodhur kjo.

**Kryesuesi** thekson:- drejtoria e paraqiti arsyetimin për me hy si pikë shtesë dhe kur të diskutohet pika ka me dhënë sqarime më të hollësishme. A keni edhe ndonjë diskutim për materialin shtesë, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 12 për , 3 abstenim (nga grupi parlamentarë i PDK-së). Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit njëzëri.

## U MIRATUA RENDI I PUNËS

**Procedojmë me këtë rend të punës:-**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Plotësimi i Komitetit për Komunitete si komitet obligativ në komunën e Hanit të Elezit.
4. Miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtor/esh në Institucionin Parashkollar, Hani i Elezit.
5. Shqyrtimi i draft rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
6. Shqyrtimi i draft rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.
7. Shqyrtimi i informatës mbi gjendjen në shëndetësi.
8. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvacioneve në bujqësi.
9. Propozim vendim për transfero të mjeteve në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa për vitin 2020.
10. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

### **2. Shqyrtimi i gjendjes rreth koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Medina Imishti** thekson:- gjatë këtij muaji kemi pasur 22 pacientë të cilët ishin të infektuar me koronavirusë. Për momentin i kemi 11 raste që janë aktive.

**Sabedin Hasallari** thekson:- a ka pas raste të vdekjes të regjistruala me koronavirusë në komunën tonë. Për çfarë arsyen nuk bëhet testi për personat të cilët shërohen nga koronavirusi që i njëjti isha edhe vetë. Kam pyetur në institutin kombëtarë ata kanë potencuar që nuk munden me bërë test.

**Medina Imishti** thekson:-kemi pasur vetëm një rast të vdekjes nga koronavirusi, ndërsa sa i përket ritestimit kemi pasur vetëm rastet e para që ka qenë një numër prej nëntë pacientëve të cilët janë ritestuar. Nga instituti është marr vendim që mos me pasur ritestim për shkak të kapaciteteve që ata nuk i kanë por e llogaritin periudhën prej 14 ditëve si shërim i pacientëve varësisht nëse kanë simptoma kalojnë në 17 ditë. Testimet nuk varen prej QKMF-së por vetëm i referojmë rastet për në institut dhe varet prej kapaciteteve të atyre.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

### **3. Plotësimi i Komitetit për Komunitete si komitet obligativ në komunën e Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- këtu bëhet fjalë për rrotacion brenda një subjekti politikë dhe bëhet fjalë për grupin parlamentarë të LDK-së që znj. Hanumshahe Dibrani do ta zëvendëson znj. Samire Curri. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U MIRATUA PLOTËSIM I KOMITETIT PËR KOKMUNITETE SI KOMITET OBLIGATIV NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT**

### **4. Miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për përgjedhjen e drejtor/esh në Institucionin Parashkollar, Hani i Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi** thekson:- në bazë të udhëzimit administrativë parashihet që formimi i komisionit për përgjedhjen e drejtor/esh në Institucionin Parashkollar, Hani i Elezit duhet të miratohet në kuvendin e komunës. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në tabel i pash disa emra të cilat kanë aplikuar dhe a ka qenë kjo praktikë apo është hera e parë që po bëhet.

**Mefail Suma** thekson:- parafolësi ka pak të drejtë sepse nëse e marrim dhe e lexojmë ligjin dhe statutin del se kjo pikë e rendit të ditës nuk është kompetencë dhe përgjegjësi e kuvendit të komunës por është në përgjegjësi të drejtorit të arsimit.

**Menduh Vlashi** thekson:- deri sa jam drejtorë kjo praktikë është për herë të parë sepse është hera e parë që kemi pasur shumë kërkesa dhe nuk kemi mundur me i përfshirë të gjithë në listën e ngushtë. Herëve të tjera për një vend pune kanë konkurruar tre, katër apo pesë persona dhe janë ftuar të gjithë edhe në test edhe në intervistë edhe nëse nuk i kanë pasur dokumentacionet komplet. Në momentin që kanë hyrë në test ata të cilët nuk i kanë pasur dokumentet komplet ju kemi treguar. Kësaj radhe kemi pasur shumë dhe i kemi paralajmërua për shkak se edhe me udhëzim administrativë përcaktohet .

**Mefail Suma** thekson:- nuk e di sa fëmijë janë paraqitur në institucionin para shkollorë dhe është mirë ta analizoni se a ka nevojë me hapë vend të punës për pranim të drejtorit në këtë institucion për shkak sa mësimdhënës do të pranohen drejtor, mirëpo drejtor i kujt do të jetë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- nëse praktikohet kjo formë është mirë të praktikohet gjithmonë për shkak se ata të cilët nuk i plotësojnë kriteret të njoftohen me kohë në mënyrë që ta dinë se çka me plotësuar në dokumentacionin e tyre.

**Sead Vila** thekson:- për mua është e pa pranueshme, jo etike dhe jo shumë e mirë për me i publikuar emrat e personave të cilët nuk janë pranuar me një pozitë të caktuar për shkak se llogaritet një pasqyrim negativë për personat të cilët nuk janë pranuar sepse kanë kryer kualifikime të ndryshme pavarëshishtë se mund të jenë jo adekuat apo mos ti keni të kompletuar dokumentet. Unë mendojë që do të ishte më mirë një formë e tjetër e komunikimit e jo me u njoftuar të gjithë qytetarët e komunës me një dështim në konkurs për personat konkretë.

**Florim Shkreta** thekson:- lista që është publikuar për personat të cilët nuk janë pranuar dhe kjo nuk është praktikuar asnjë herë në komunën tonë për shkak se çdo person që aplikon e ka si kusht numrin e telefonit ta shënon në aplikacion dhe mund të njoftohet që nuk i ka plotësuar kushtet.

**Rufki Suma** thekson:- unë mendojë që problematik janë ligjet në fuqi kemi probleme edhe me shpallur konkurse dhe fatmirësish që mundësin e kemi në arsim me shpall konkurs. Me ligj të ri për arsim duhet të bëhet 30 ditë njoftimi me bërë dhe me shpall në vebfaqen zyrtare të komunës dhe pas 30 dite fillon me rrjedhë afati zyrtarë i konkursit që është 15 ditë . Çështja e formimit të komisionit për përzgjedhjen e drejtorit më herët nuk e kemi miratuar në kuvendë për shkak se ligji nuk na ka obliguar , kurse tash ligji na obligonë për me formuar këtë komision për drejtor/esh në Institucionin Parashkollor, Hani i Elezit. Sa i përket njoftimit të kandidatëve me ligj është e përcaktuar se nëse një kandidat nuk i ka plotësuar kriteret institucioni ka obligim ligjorë që në afat prej tre ditëve me bërë një njoftim në mënyrë që me i dhënë edhe një afat shtesë

**Menduh Vlashi** thekson:- çerdhja është institucion në veti dhe kush do ta menaxhon punën e çerdhes nëse nuk përzgjedhim drejtor për shkak se është e rregullime me ligj , ndërsa sa i përket numrit të fëmijëve është katërdhjetë fëmijë. Sa i përket publikimit të emrave që nuk i kanë të kompletuar dokumentacionet është e paraparë me udhëzim që tu publikohen emrat sepse nëse u mungon ndonjë dokument me mundur me i plotësuar.

**Mefail Suma** thekson:- është bërë rutinë në komunë se nëse ka dikush me u pranuar po merret vesh me një herë , që do të thotë po bëhet një para fushat sepse ende pa u shpallur konkursi po dihet se kush do të pranohet në punë . Ju kisha lutar mos e shtini kuvendin në ato lojëra me bërë komision kur dihet se kush pranohet .

**Florim Shkreta** thekson:- a i keni vendosur emër çerdhes.

**Menduh Vlashi** thekson:- emër të çerdhes momentalisht nuk kemi por duhet të emërhohet.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për , 1 kundër (grupi parlamentar Nisma), 1 kundër nga (grupi parlamentarë i PDK-së z.Florim Shkreta).

#### U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E DREJTOR/ESH NË INSTITUCIONIN PARASHKOLLORË HANI I ELEZIT.

##### 5. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më Pak se Një Vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Nexhmedin Daci** thekson:- kjo rregullore është hartuar me ligjin mbi dhënien në shfrytëzim dhe në këmbim të pronës komunale . Rregullorja është hartuar nga asociacioni i komunave të Kosovës që kanë marr pjesë edhe përfaqësuesit nga komuna jonë. Rregullorja i rregullon procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në afat më të shkurtër se një vit. Rregullorja është shqyrtuar në KPF dhe do të shqyrtohet në kuvend , në debat publik dhe pastaj përcillet për miratim në kuvendin e komunës.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në KPF e diskutuan më pakë se një vit që do të thotë i bien më pak se dymbëdhjetë muaj dhe te neni 16 pika 2 shfrytëzuesve të tillë i mundësohet shfrytëzimi i pronës së paluajtshme me afat prej 12 muaj, me kusht që t'i kryejnë obligimet sipas kontratës së shfrytëzimit dhe është mirë me sqaruar këtë.

**Nexhmedin Daci** thekson:- për lokalet të cilat i kanë në shfrytëzim kemi bërë përpjekje me zyrën ligjore që në afat më të shkurtë se një vit me rregulluar statusin e këtyre lokaleve dhe ende nuk e kemi përfunduar për shkak se duhet ta formulojmë dhe të jetë më e përshtatshme në mënyrë që përmes kësaj rregullore me u trajtuar edhe lokalet për shkak se nuk ka pasur rregullore më herët por janë dhënë në mënyrë të një anshme prej kuvendit të komunës së Kaçanikut. Rregullorja shqyrtohet sot dhe votohet për debat publikë dhe deri kur të përcillet për kuvend do ta rregullojmë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:-unë mendojë që kjo është më shumë anë teknike për me rregulluar për shkak e duhet të ndryshohet dhe të bëhet më pak se një vit.

**Mefail Suma** thekson:- në fillim do ta kisha quajtur këtë si rregullore me bisht për shkak se nëse nuk e kuptioni sot do ta kuptioni nesër apo në ndonjë të ardhme të afërt. Komuna e ka të formuar një komision që paraprakisht i shqyrton rregulloret dhe pastaj përcillet për Komitet për Politik e Financa, në Kuvend të Komunës dhe pastaj në debat dhe kthehet për miratim në kuvend. Po më doket që kuvendi po i delegon kompetencat drejtoreve nëse miratohet kjo rregullore. Kompetencë me rregullore nuk kanë drejtoret me bërë vendime e me dhënë pronë në shfrytëzim. Hartuesi i kësaj rregullore nuk e ka paraqitur paragrafin dhe nenin e statutit të komunës për shkak se në statutin e komunës të vitit 2014 nuk ekzistonjë kompetencat dhe përgjegjësitë e kuvendit të komunës dhe nëse ende nuk janë të përfshira në statut është mirë të ndryshohet statuti dhe rregullorja e punës sepse kanë shumë mangësi. Kuvendi komunal i Prishtinës në statut i ka të parapara në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Neni 33.2 i statutit të komunës së Prishtinës parashevë si shtesë në listën e përgjegjësive të padelegueshme të marrura nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale e cila paraqet më lartë çështjet në kompetencë të komunës dhe nuk mund të delegohen: vendimet që kanë të bëjnë me pronën e komunës, miratimin e planit zhvillimorë komunal, planit zhvillimorë urban, planit rregullues urbanë. Këto të cilat i theksova nuk mund të delegohen. Nëse biem ndeshmë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale duke i marr përbazë ligjet tjera është mirë të kemi kujdes në këtë çështje. Është e drejtë e komunës që të ketë pasuri të patundshme por komuna duhet ta menaxhojë mirë pasurinë e patundshme. Është mandati tretë dhe sinoni me marr edhe mandatin e katër por shumë keç e keni menaxhuar pronën komunale. Nëse nuk më argumentohet me ligj që kemi të drejtë me deleguar këtë kompetencë apo këtë përgjegjësi te drejtoret nuk do ta ngrish dorë, por nëse ma argumentoni atëherë do ta votojë për, andaj ju sugjeroj që ta shqyrtoni këtë mirë.

**Kryesuesi** thekson:-dhënia në shfrytëzim e pronës është kompetencë e kuvendit të komunës dhe nëse gabojmë në miratim përgjegjësin e kemi kolektive e jo individuale, por në qoftë se e votojmë këtë dhe është në kundërshtim me ligjet në fuqi, Ministria e Pushtetit Lokal e kthen për rishqyrtim në kuvendin e komunës.

**Sead Vila** thekson:- sa i përket kësaj rregullore mendojë që është një nismë e mirë ligjore që pronat e paluajtshme të komunës që ipen në shfrytëzim në periudhë deri në një vit, e që mendoj që ka elemente të drejtë për drejta që mund të përfitojë komuna se varësisht se për çfarë veprimtarie do të merret në shfrytëzim prona. Neni tetë veprimtaria që do të zhvillojë, është mirë të dihet për veprimtaritë që do të zhvillon në mënyrë që komisioni i cili ja lejon mos me pasur pasoja çoftë grupe të rinjve apo të biznesit. Është një nismë e mirë që mund të ketë dobi edhe komuniteti dhe komuna.

**Florim Shkreta** thekson:- pikat të cilat janë vendosur te neni gjashtëmbëdhjetë po më doken që janë një far lloj diskriminimi dhe është mirë të ipet sqarim për këto pika.

**Teuta Shkreta** thekson:- a kemi në pronë komunale shtëpi banimi dhe cilat janë.

**Sabedin Hasallari** thekson:- këto procedura a vleinë edhe për banorët të cilët nuk janë shtetas të Republikës sonë që do të thotë për personat jorezidentë.

**Nexhmedin Daci** thekson:- u potencova edhe në fillim që këtë rregullore e ka hartuar Asociacioni i Komunave të Kosovës me pjesëmarrje të përfaqësuesve të gjitha komunave. Draft rregullorja është plotësisht në pajtim me ligjin, por këtu bëhet fjalë për dhënien në shfrytëzim për një afat më të shkurtër se një vit që mund të jepim vetëm për tre apo shtatë ditë dikujt për me shfrytëzuar një hapësirë publike dhe kjo nuk del në kuvendë por strukturat përkatëse të formuar nga kryetari mund të vendosin. Ligji për shfrytëzimin e pronës komunale e parashevë saktë dhënien në shfrytëzim të pronës dhe nuk mund të ipen në shfrytëzim afat gjatë pronat e komunës pa u miratuar në kuvendin e komunës. Rregullorja nuk i është dërguar kuvendit drejtë për drejtë por është shqyruar në bord të drejtoreve. U përmendë diskriminimi unë mendojë që nuk ka diskriminim por shfrytëzuesit ekzistues të gjitha lejet i kanë marr prej kuvendit të komunës së Kaçanikut dhe janë shfrytëzues të

ligjshëm dhe për çdo vit bëjmë kontratë me ato lokale. Sa i përket shtetasve të huaj i kanë të drejtat sikur qytetarët e tonë.

**Mefail Suma** thekson:- si është i rregulluar statusi i banesë “Luri” i cili e ka ndërtuar , në komunë a është e rregulluar ligjërisht apo jo, për shkak se banesat janë shitura dhe toka a është e komunës.

**Nexhmedin Daci** thekson:- në bazë të ligjit ajo pronë ku është e vendosur banesa ju takon banorëve.

**Kryesuesi** thekson:- në mandatin e kaluar përmes kuvendit janë rregulluar parcelat.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- neni 14 parashihet shkëputja e kontratës, komuna ka të drejtë në mënyrë të një anshme duke i njoftuar palët brenda shtatë ditëve . Shfrytëzuesi a ka të drejtë në mënyrë të një anshme ta prishë kontratë dhe me cilat kritere.

**Nexhmedin Daci** thekson:- nëse kontrata shkëputet në mënyrë të një anshme duhet me i kryer obligimet ndaj komunës pala.

**Bajrush Laçi** thekson:- kontrata e përcakton saktësisht se palët njëra tjetrës edhe shfrytëzuesi edhe dhënësi në shfrytëzim e kanë të drejtën e shfrytëzimit për me shkëputur kontratë që do të thotë është mënyrë e dyanshme. Për ninen të cilin po diskutohet parasheh që kryetari i komunës pas shqyrtimit të raportit përfundimtarë ka të drejtë nëse vëren diçka që nuk është në rregull. Neni gjashtë i kontratës e përcakton se në rast të shkëputjes së kontratës para afatit me marrëveshjen e palëve kontraktuese obligimet e mbetur por duke e lajmëruar palët njëra tjetrën.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për , 1 kundër nga grupei parlamentarë nisma, 1 kundër nga grupei parlamentarë i PDK-së z.Florim Shkreta.

#### U VOTUA DRAFT RREGULLORJA PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT TË PRONËS SË PALUAJTHSHME TË KOMUNËS

##### 6. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin,,

**Medina Imishti** thekson:- me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës, komisioni i komunës e ka harmonizuar këtë rregullore në bazë të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës. Kjo rregullore përcakton parimet e çdo përfaqësuesi të ndonjë subjekti që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve dhe gjithashtu do të ketë një mundësi reale për të pasur një mundësi të statistikave për gjetje në zbatim të drejtave të fëmijëve në komunë. Rregullorja në fjalë e obligonë komunën që ta emëron një zyrtarë për mbrojtjen e fëmijëve i cili do të jetë i obliguar që ta hartojë një plan vjetor dhe do të mbledhë statistika periodike dhe vjetore gjatë mbrojtjes së fëmijëve në komunën tonë të cilat do të diskutohen në kuvendë. Komuna është e obliguar të themelojë mekanizëm për mbrojtjen e fëmijëve që do të përfshihen të gjithë përgjegjësit për mbrojtjen e fëmijëve sipas ligjeve në fuqi. Në këtë takim pjesëmarrës është edhe drejtori i qendrës për punë sociale të cilat mund ti parashtroni ndonjë pyetje ndërkohë. Materialin e keni pranuar me kohë dhe ndonëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Mefail Suma** thekson:- qytetarët të cilët i kanë kushtet më të mira dhe që i kanë fëmijët me të meta fizike apo psikike a do ta kenë trajtimin e njëjtë sikur fëmijët e personave të cilët i kanë kushtet më të rënda sociale.

**Teuta Shkreta** thekson:- sa kemi numër të fëmijëve pa përkujdesje të prindërve. Familjet të cilat kanë njërin prind të punësuar dhe marrin një pagë prej 200 € por i kanë gjashtë fëmijë, a keni ndonjë listë të ranguar se si mund të ja dalin ata, për shkak se disa familje nuk kanë të punësuar por marrin ndonjë social dhe ndonjë ndihmë që u epet nga qendra për punë sociale, kurse ata familje mund të marrin vetëm 200 € dhe asnjë ndihmë tjetër dhe si mund të ja dalin brenda muajit. Duhet të bëhet një listë që komuna ti ketë parasysh këto raste për shkak se nuk paraqiten në komunë si skamnorë.

**Nora Xhoni** thekson:- e mirëpresim këtë rregullore dhe besojë që në bashkëpunim me ne kjo rregullore do të gjeljë zbatim sepse kjo rregullore na prek të gjithëve këtu si prind dhe si familjarë.

**Sabrije Krasniçi** thekson:- enti social çfarë ka ndërmarr deri sot për fëmijët të cilët qëndrojnë te kufiri. E dimë që policia është e njoftuar dhe familja por përsëri ata po dalin dhe është mirë që komuna me bërë ndonjë zgjidhje.

**Florim Shkreta** thekson:- a është ndërmarr diçka me fëmijët të cilët merren me dukuri negative (duhan dhe substanca narkotike).

**Sead Vila** thekson:- e përkrah këtë rregullore që është përgatitur por sugjeroj që mos të mbetet si rregullore por edhe pse te qendra për punë sociale po punohet është mirë që të shtohen kapacitet për mbrojtjen e këtyre fëmijëve.

**Amir Bushi** thekson:- ligji e përcakton se çdo fëmijë është i barabartë dhe nuk e cakton pasurinë, etnitetin apo gjininë. Fëmijë të cilat i kemi në strehim familjarë i kemi njëmbëdhjetë dhe nga ministria secila familje i merr nga 100 €. Familjet të cilat kanë të ardhura më pakë është ligji që e përcakton për shkak se pavarësisht se një familje ka një pagë të vogël sipas ligjit nuk i takon ndihma sociale. Për fëmijët në rrugë vitin e kaluar kemi pasur shumë problem por në këtë vit për shkak të pandemisë nuk kemi pasur probleme por ndoshta kemi më pak raste por jemi ndër qendrat e para që bëjmë iniciime në polici për fëmijët në rrugë. Për ato fëmijë që kemi iniciuar raste familjet e tyre marrin ndihmë sociale. Sa i përketë zbatimit të rregullores kryetari i komunës do ta cakton një zyrtarë për mbarëvajtjen e këtij procesi.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- a ka pasur ndonjë rast në familje që është ushtruar dhunë ndaj fëmijëve.

**Amir Bushi** thekson:- ka pas raste që ka pasur dhunë në familje që edhe fëmijët kanë qenë prezantë. Vitin e kaluar janë katër fëmijë që janë braktisur nga nëna dhe nga baba e që fëmija ka qenë pjesëmarrës në dhunë që ka pësuar dhunë.

**Nora Xhoni** thekson:- lysparët që vijën pavarësisht që rrinë tërë ditën në rrugë në të ftohët por a keni të drejta me ndërmarr diçka ndaj tyre.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në kuwend vitin e kaluar kam kërkuar që të merren masa të vendosen mbrojtëse në rrugë për shkak se ju e dini që një fëmijë ka humbur jetën. U përmendë çështja e fëmijëve që dalinë në rrugë përveç atyre që duhet të merren masa duhet të bëhen edhe para ndalesa e mos të presim që të ndodhë diçka e pastaj të merremi me atë çështje.

**Florim Shkreta** thekson:- a keni iniciuar ndonjë rast në polici për ndonjë fëmijë që ka përdorur substanca narkotike pasi që është shqetësuese kjo çështje. Në midis qendrës gjenden substanca narkotike para hyrjes së Xhamisë në qendër dhe është shqetësim për mu, mirëpo për deri sa gjenden kjo dihet se është prezantë.

**Amir Bushi** thekson:- çështja e dukurive negative bisedohet për çdo ditë por emra nuk kemi sepse ne jemi institucion që e pranojmë ankesën dhe pastaj merremi me atë çështje. Në takime të përgjithshme kam qenë dhe kam potencuar se ata që kanë ndonjë rast qoftë edhe në familje në ta tregojnë për shkak se ne i kemi kontaktet me organizatat joqeveritare në Ferizaj të cilat i trajtojnë këto çështje. Kam mbajtur ligjëratave nëpër shkolla për këtë çështje po nuk po mundemi me bërë diçka ma shumë si institucion i vetëm. Rregullorja që është prezantuar për shqyrtim është shumë e mirë sepse u jepë përgjegjësi të gjitha institacioneve.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U VOTUA DRAFT RREGULLORJA PËR PËRKUJDESJEN DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

##### 7. Shqyrtimi i informatës mbi gjendjen në shëndetësi.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Medina Imishti** thekson:- informata mbi gjendjen në shëndetësi është përgatitur nga drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenies sociale në mënyrë të detajuar dhe përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka më të veçantë nuk kam me shtuar. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtron.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kërkoi sqarim për ambulanten në fshatin Gorancë pse nuk ka funksionuar për shkak se ka qenë shumë e nevojshme për me i kryer shërbimet qytetarët.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- e përgëzojë stafin mjekësorë që ka bërë një punë të mirë në këtë kohë pandemie po ashtu kanë bërë edhe vizitat shtëpiake në këtë kohë pandemie.

**Isni Bushi** thekson:-informatën e kam analizuar dhe shihet se në shëndetësi po punohet dhe stafi që punon është direkt i rrezikuar nga personat të cilët janë të sëmurë. Edhe pse kemi pasur rastet të infektimit të punëtorëve dhe stafit të reduktuar punët janë kryer mirë. E përgëzojë stafin mjekësorë që po e bënë një punë të palodhshme vazhdimesht. Kur do të fillojnë me u bërë testet sterelogjike?

**Sabedin Hasallari** thekson:- sa shtretër janë të përgatitur për kovid. Më herët kam kërkuar për sjelljen e aparatit të mamografisë në Han të Elezit dhe kërkoi që për këtë çështje të më jasin përkrahje edhe këshilltarët e tjerët të asamblesë sepse është një çështje prioritare. Kërkoi edhe një zotim nga kryetari i komunës që në vitin tjetër të jetë prioritet sjellja e aparatit të mamografisë në Han të Elezit kur dihen kushtet të cilat janë në për shkak se është dukuri shqetësuese në Han të Elezit.

**Sead Vila** thekson:- është një informatë shumë e detajuar dhe mirë e përgatitur. Edhe pse jemi në situatë të pandemisë e përgëzoj për informatën që është përgatitur nga drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale .

**Medina Imishti** thekson:- ambulancë në fshatin Gorancë jemi detyruar me mbyllur për shkak të stafit që na ka vytë edhe në pikën kufitare dhe në ambulantë në Han të Elezit. Për teste sterelogjike jemi në procedurë të nënshkrimit të kontratës dhe nëse lidhet kontrata në këtë javë besoj që në javën e ardhshme do ti kemi furnizimet prej operatorit . Për çështjen e aparatit të mamografisë në këtë vit nuk kam bërë ndonjë kërkesë në ministrinë përkatëse për shkak të pandemisë , ndërsa për vitin e kaluar të kam njoftuar për informatat që më janë dhënë nga niveli qendrorë sepse e kemi vetëm një aparat të mamografisë dhe shkon vetëm nëpër komuna të mëdha. Planifikimi jonë në këtë vit ka qenë që në bashkëpunim me komunën e Ferizajt me ua mundësuar atyre grave të cilat nuk kanë kushte në bashkëpunim me qendrën për punë sociale që ata me kryer por edhe në këtë vit nuk kemi mundur me bërë. Për momentin i kemi dhjetë shtretër për kovid në QKMF.

**Sabedin Hasallari** thekson:- është mirë që kryetari ta merr si prioritet për me sjellë aparatin në Han të Elezit për shkak të gjendjes së krijuar këtu tek ne.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 8. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve në bujqësi.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Zaim Bela** thekson:- brenda mundësive buxhetore për çdo vit kemi dhënë subvencione në bujqësi. Është shqetësuese për shkak se fermerë që ka mbjell grurë kemi pasur vetëm një aplikues dhe e kemi subvencionuar. Kemi dhënë subvencione për gurë, serra tunel dhe shoqatës së bletarëve. Kemi pasur 32 kërkesa dhe të gjitha ata që kanë aplikuar kanë përfituar. Materialin keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund ta parashtroni.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- serrat janë subvencionuar për ari kërkoj sqarim se sa është financuar për ari.

**Zaim Bela** thekson:- serrat janë subvencionuar nga 30 € për një ari.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 9. Propozim vendim për transfero të mjeteve në kategorinë ekonomike paga dhe shtesa për vitin 2020.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- sipas ligjit për financa dhe përgjegjësi dhe sipas ligjit të buxhetit na lejohet të bëjmë transfere të mjeteve nga një drejtori në drejtorinë tjeter. Propozimi për transfere të mjeteve është bërë duke i pasur kërkesat të cilat janë dërguar në mësimdhënësit e shkollave në drejtori të arsimit për pagesën e shujtave dhe obligimeve të tjera të cilat dalin nga kontrata kolektive. Komuna vetëm këto mjete financiare i ka që na kanë mbetur të lira të cilat mundemi me i shfrytëzuar për pagesën e shujtave për vitin 2017 ndërsa për vitet tjera duhet ti shikojmë mundësitë. Drejtoria e Arsimit ka parashtruar kërkesë në Ministri të Financave dhe në Ministri të Arsimit me u përfshirë pagesa e shujtave për katër vite por ende nuk kemi marr përgjigje. Materialin e keni në detaje dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim

**Mehmet Ballazhi** thekson:- po më vjen mirë që keni filluar me zbatuar kontratën kolektive sepse në fillim kur e kam paraqitur si çështje në mënyrë decidive u potencua që nuk ka mjete financiare, mirëpo me gjithë atë është keq pse vetëm për vitin 2017. Për vitin e ardhshëm nuk di si do të ndahen mjetet financiare për dy vite për shkak se nuk është bërë në planifikim të buxhetit të komunës dhe për atë në fillim kemi potencuar që po planifikohet keq apo po keq planifikohet dhe është dashur të merren parasysh këto çështje .

**Sead Vila** thekson:- është e vërtetë që është diskutuar edhe në seancat paraprake për shkak se kjo çështje është ligjore sepse në bazë të kontratës kolektive ju takon sikur se në sektor tjeter që i marrin beneficionet edhe arsimit i takon kjo. Në opinion paragjykohet ndonjë herë për arsimin por nuk është krejt terr siç potencojnë disa persona por në arsim punohet. Është mirë që është marr kjo iniciativë për shkak se ne kemi bërë një marrëveshje paraprake që mos me hyjë me procedura gjyqisore por me gjet ndonjë mënyrë dhe konsensus që është në dobi të dy palëve dhe do të ishte mirë që mos me u stergjatur pjesa tjeter për vitet e mbeturë por që gjinden forma dhe mënyra.

**Sabedin Hasallari** thekson:-kontrata kolektive a vlen për arsimtarët sepse ne i kemi edhe punëtorët shëndetësorë, punëtorët e shërbimit civil për shkak se po bëhet një ndarje dhe një far diskriminimi.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- sipas informacioneve që i kam Komuna e Kaçanikut pagesën e shujtave e ka krye me mjetet financiare të cilat ishin të planifikuara për ligjin e pagave dhe ligji pagave nuk u aplikua për shkak se gjykata kushtetuese e kthej prapë dhe qeveria nuk u ka marr mjetet komunave.

**Shabi Rexhallari** thekson:- personeli shëndetësorë shujtat i merr me pagë , ndërsa për shërbimin civil ende nuk ka hyrë por para shtatë viteve i kanë marr një herë. Në momentin që është miratuar buxheti janë planifikuar pagat me ngritje dhe në muajin mars janë planifikuar në kategorinë rezervë në mënyrë që me pritur se ligjin se a po hynë në fuqi apo jo dhe në momentin që nuk hynë në fuqi ligji mjetet financiare mbeten në rezervë, mirëpo sipas ligjit këto mjete mund të shfrytëzohen në investime kapitale dhe pastaj e modifikuan që mund të shfrytëzohen edhe në kategori të tjera por jo në paga. Komuna nuk ka pasur ndonjë ankesë nga sindikata që është ankuar në gjykatë për shkak se këta mjete i kishim dedikuar direkt në pagesën e shujtave dhe pasi që nuk kemi pasur ankesa i kemi dedikuar në investime kapitale. Kërkesë kemi parashtruar në Ministri të Financave por nuk kemi marr përgjigje ende.

**Menduh Vlashi** thekson:- për këtë punë fajin nuk e merr askush se kontrata kolektive është nënshkruar në vitin 2017 dhe nuk e di se në çfarë forme ka filluar në shëndetësi me u paguar. Mësimdhënësit dhe shërbyesit civil nuk kanë bërë kërkesë asnjë herë për me ua kompensuar shujtat dhe gabimi më i madh është se nuk kanë parashtruar kërkesë në fillim të viti të kaluar këtë ua kam thënë edhe drejtoreve të shkollave në mënyrë që edhe kuvendi me u marr me këtë çështje për shkak se mjetet financiare duhet të planifikohen me kohë . Për vitin 2017 nuk i ka kërkuar askush as nga asambleja komunale, as mësimdhënësit por as ne si ekzekutiv i komunës, mirëpo nuk janë kërkuar as në vitin 2018 dhe 2019 . Kontrata kolektive vlen vetëm tri vite por ishte një nen që parasheh që nëse nuk merren vesh për me vazduhar apo për me shkëputur vlen edhe një vit dhe tash kërkesë kanë parashtruar të gjithë mësimdhënësit e Kosovës për shkak se u kalon afati. Të gjitha shkollat e komunës i kanë dërguar shënimet dhe kërkesën e kam parashtruar në Ministri të Financave dhe në Ministri të Arsimit. Mjetet financiare të cilat i kemi tepër me këtë vendim do të dedikohen por varet a do ta pranon Ministria e Financave .

**Sead Vila** thekson:- defekti më i madh është te ne që sendet të cilat nënshkruhen pa u ankuar nuk i shtyrë në zbatim dhe do të ishte mirë që gjérat të cilat i parasheh ligji duhet të rregullohen në sistem.

**Menduh Vlashi** thekson:- pagat dhe mëditjet nuk mund të lëvizin shumë por varet prej nivelit qendrorë , për shkak se ata i kanë përcaktuar , për arsim, për shëndetësi, për shërbim civil, ndërsa kuvendi i komunës mund ti përcakton vetëm investimet kapitale në projekte të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 14 për 1 abstenim nga grupei parlamentarë i PDK-së (z.Florim Shkreta).

#### U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR TRANSFERE NË KATEGORINË EKONOMIKE PAGA DHE SHTESA PËR VITIN 2020

##### 10. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mefail Suma** thekson:- në statut e kam lexuar që me vendim të kuvendit komuna është e obliguar që ta cakton shumën për ndarjen e mjeteve financiare për asamblistët , mirëpo me që pagesa është e përcaktuar nga Ministria , kërkoi që në kolegjumin e kryesuesve të kuvendeve komunale të Kosovës me diskutuar çështje të ngritisës së pagave. Shpesh po dëgjojë që lagja e re, Meliq, një pjesë e Seçishtës kanë reduktime me ujë në mëngjes dhe mbrëmje nga dy orë . Kërkoi përgjigje me shkrim si është i rregulluar reduktimi i ujit në lagje të re, Meliq dhe në pjesën e Seçishtës. Kur e kam lexuar marrëveshjen e komunës me kompaninë “Bifurkacioni” një vit kish pas që i kishte skaduar afati. A është vazduhar kontrata me kompaninë “Bifurkacioni”.

**Kryesuesi** thekson:- me ligj të pagave është përcaktuar çështja e pagesës së asamblistëve të komunave , mirëpo nuk është miratuar dhe kemi mbetur në këtë mënyrë siç jemi.

**Sead Vila** thekson:- e kam lexuar për një rregullore e cila ka hyrë në fuqi me datë dy prill të vitit 2009 dhe gjatë leximit rastisa që kujt i takon por vetëm përmendet përfaqësimi partiakë dhe gjinorë dhe asnjë nen nuk e përcakton numrin dhe formën e rregullimit të saj në komitetin për politik dhe financa dhe komitetin për komunitete.

**Mefail Suma** thekson:- kuvendi mund ta propozon një komitet për shëndetësi apo për arsim dhe do të përfshiheshin edhe grupet e tjera parlamentare.

**Kryesuesi** thekson:- çështja e formimit të komiteteve obligative është e precizuar me Ligj për Vetëqeverisje Lokale dhe me udhëzim administrativ të Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe themelimin e këtyre e kemi bërë në bazë të udhëzimit. Kuvendi i komunës i ka themeluar katër komitete konsultative dhe në kuadër të këtyre komiteteve është edhe komiteti për arsim kulturë shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Me rekomandim të Ministrisë së Pushtetit Lokal është themeluar komiteti për persona me aftësi të kufizuara dhe paneli i cili ka bërë përzgjedhjen është themeluar prej kuvendit të komunës.

**Florim Shkreta** thekson:- a ka ndonjë mjek që do të subvencionohet prej buxhetit të komunës për ndonjë specializim dhe për cilët mjek bëhet fjalë. A ka mjek në QKMF që vendimin e kontratës e ka diçka tjetër dhe punon diçka tjetër. Me që nuk është kryetari i komunës prezantë parashtrojë këtë pyetje dhe kërkoj përgjigje me shkrim për vizitën e afaristit Sedat Peker në komunën me datë 05.11.2020 se çka kemi përfituar na si komunë prej këtij vizitorit.

**Medina Imishti** thekson:- për momentin e kemi përkrahur një mjeke znj.Arta Drini e cila do të fillon specializimin në mjekësinë familjare për shkak se vetëm ajo ka qenë e interesuar për specializim në mjekësinë familjare. Pjesa e tjetër e mjekëve kanë shkuar varësisht se ku kanë dashur specializimin do ta kryen me vetë financim , ndërsa komuna i përkrahë mjekët të cilët shkojnë për mjekësi familjare. Sa i përket kontratave në QKMF i kam pa dhe mjekët punojnë për atë punë të cilën e kanë lidhur kontratën

**Florim Shkreta** thekson:- kërkoj informacion ta dijë për z.Lumni Berisha si e ka të rregulluar kontratën dhe çka punon.

**Medina Imishti** thekson:- kontratën e ka laborantë, ndërsa punon në emergjencë.

**Florim Shkreta** thekson:- a mendoni që kjo është shkelje.

**Medina Imishti** thekson:- z.Lumni Berisha prej suspendimit të cilën e ka pasur kur është kthyer në punë ka kaluar në kujdestari dhe ka mbetur në të njëjtën punë aty.

**Florim Shkreta** thekson:- z.Lumni Berisha e kryen punën sikur të një motre medicionale a në fakt paguhet edhe për 100 € dhe nëse e ka vendimin si laborantë pse keni pranuar laborant tjetër .

**Medina Imishti** thekson:- kemi pranuar laborantë për shkak se z.Lumni Berisha punon në kujdestari për shkak të suspendime që i ka pasur.

**Florim Shkreta** thekson:- nëse subvencionohet prej komunës znj.Arta Drini çfarë të mire do të sheh komuna prej sajë për shkak se në momentin që do ta kryen specializimin do të del në pension.

**Sabrije Krasniçi** thekson:- a ka pasur lajmërim që fëmija e ka kryer shkollën fillore , mirëpo nuk e ka vazhduar shkollën e mesme pér arsyet ndryshme dhe a keni biseduar si drejtori e arsimit pér këtë çështje. Sa fëmijë në shkollat fillore dhe në shkollat e mesme janë dërguar në pedagogë. Pasi shkollat në Han të Elezit e kanë vetëm një pedagogë, a kanë edhe psikolog. Personat të cilët i bartin mbeturinat shumë herë i kam parë prapa kamionit të kapur dhe unë mendoj që është rrezik me qëndruar në atë formë.

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- qendra tregtare ETC e cila është hapur dhe është afër shkollës por a do të mund të mbahen fëmijët nën kontroll.

**Menduh Vlashi** thekson:- nuk kemi shënime pér fëmijët të cilët nuk regjistrohen në shkollë të mesme pér shkak se shkollimi fillorë është i obligueshëm ndërsa shkollimi i mesëm nuk është dhe pér atë nuk mund të marrim ndonjë masë ndaj askujt . Fëmijët të cilët e ndërpresin mësimin fillorë i kemi shënimet të gjitha dhe ka shumë pak fëmijë të cilët e ndërpresin shkollimin. Fëmijët të cilët dërgohen te pedagogu nuk kam shënime por shkollat e dinë saktë. Sa i përket psikologut jemi duke u mundura dhe nëse na lirohet ndonjë vend do ta pranojmë edhe një psikolog në kuadër të gjitha shkollave. Nga drejtori i shkollës pata një informatë pér disa ankese dhe bisedova me drejtorin e shërbimeve publike, mirëpo secila kompani ka obligim nëse ka qarkullim në magjistrale duhet ta qetë një punëtorë të vetin apo ta lajmëron policinë dhe kur të fillon me punuar nuk besojë që ka probleme.


**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim pér këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të myllur mbledhjen e kuvendit të komunës.

Ju faleminderit pér pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:45.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit  
MSc. Qamush Brava

